



Njoftim për qytetarët e Komunës së Drenasit

Regjistroni numrin tuaj personal

Duke regjistruar numrin tuaj personal në regjistrat e tatimit në pronë, ju përfitoni disa lehtësira, si mundësinë për të shfrytëzuar shërbimet elektronike dhe për të marrë vetëm një faturë për të gjitha pronat tuaja brenda një komune.

Autoritetet e tatimit në pronë synojnë të jenë moderne dhe efikase. Regjistrimi i numrit personal kontribuon në rritjen e efikasitetit dhe garanton të dhëna më të sakta dhe të besueshme në regjistra.

Përfitimet për ju si tatimpagues janë të shumta:

- Mundësi për të përfituar nga zbritja për vendbanimin parësor.
- Marrja e vetëm një fature për të gjitha pronat tuaja në një komunë, e cila dërgohet në një adresë të vetme.
- Pagesë e vetëm një komisioni bankar kur paguani tatimin për të gjitha pronat tuaja brenda të njëjtës komunë.
- Reduktim i rrezikut për pagesë gjobash dhe interesi për shkak të mos-dorëzimit të faturës.
- Më pak gjasa për fatura të dyfishta për të njëjtën pronë.
- Përdorim i shërbimeve elektronike: mund të qaseni në të gjitha faturat dhe certifikatat tuaja në çdo kohë, pavarësisht nëse keni pronë në disa komuna apo jetojnë jashtë vendit.

Për të regjistruar numrin tuaj personal, vizitoni zyrën komunale të tatimit në pronë dhe sillni me vete letërnjoftimin tuaj.

Komuna e Drenasit – gjithmonë në shërbim të qytetarëve